



BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

Shkurt 2025

BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHETIT

SHKURT 2025

Në edicionin e këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet e ZKPSH-së për muajin SHKURT 2025

U.D. Kryeprokurori i Shtetit mbajti trajnim për noterët e rinj

Prishtinë, 1 Shkurt 2025 – Me ftesë të Odës së Noterëve të Kosovës, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka mbajtur trajnim për noterët e rinj me temë “Përgjegjësia Penale e Noterit”.



Ky trajnim ka pasur për qëllim diskutimin për fusha të ndryshme të së drejtës, përfshirë këtu fushën penale dhe praktikën noteriale, me qëllim përgatitjen profesionale të pjesëmarrësve për sfidat e profesionit.



U.D. Kryeprokurori Kelmendi mori pjesë në takimin e Koordinatorit të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave me udhëheqësit e zyrave regjionale

Prishtinë, 3 shkurt 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendi i shoqëruar nga Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës z. Sami Istrefi, morën pjesë në takim në përbashkëti të Koordinatorit të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) z. Burhan Maxhuni me udhëheqësit e zyrave regjionale për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave.



Gjatë këtij takimi u diskutua raporti vjetor i punës për vitin 2024 i ZMNV-së si dhe sfidat e kësaj zyrjeje për vitin 2025.

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe profesionale për viktimat e krimit, në këtë takim u diskutua edhe Plani i Punës së Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave për vitin 2025.

Me këtë rast Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Drejtori i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës ofruan mbështetje për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave si dhe inkurajuan Koordinatorin e ZMNV dhe udhëheqësit e zyrave regjionale që të vazhdojnë të mbështesin viktimat e krimit.

Krerët e sistemit prokurorial vizitojnë Prokurorinë e Apelit dhe Prokurorinë Themelore në Ferizaj

Prishtinë, 3 shkurt 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi,

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, vizituan Prokurorinë e Apelit dhe Prokurorinë Themelore në Ferizaj, ku janë pritur nga kryeprokurorët Agron Bajrami dhe Burim Çerkini.

Me këtë rast, z. Hajdaraj dhe z. Kelmendi uruan fillimisht z. Bajrami për zgjedhjen e tij në krye të Prokurorisë së Apelit dhe z. Çerkini në krye të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, duke theksuar se kanë përkrahjen e tyre për zbatimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore.



Nga ana tjetër, Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, Agron Bajrami dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Burim Çerkini, falënderuan krerët e sistemit prokurorial për vizitën e tyre, duke informuar ata për proceset aktuale të punës dhe sfidat e identifikuara pas pranimit të detyrave të reja.



Bashkëbiseduesit u pajtuan në takimin e sotëm për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe për krijimin e kushteve sa më të favorshme të punës, zbatimin e planeve të punës dhe angazhimin e shtuar për fuqizimin e sundimit të ligjit në vendin tonë.

U.D. Kryeprokurori Kelmendi mori pjesë në takimin e 262-të të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 5 shkurt 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi mori pjesë Takimin e 262-të, të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, me ç'rast KPK-ja mori vendimet si vijojnë:



Refuzoi themelimin e Panelit hetimor AD.nr.01/2025 për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Pejë;

Miratoi Raportin e Komisionit për Administrimin e Prokurorive për trajtimin e rasteve me kryerës të panjohur, me opsionin e tretë dhe ka obliguar Ushtuesin e Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për nxjerrjen e një vendimi të detyrueshëm për zbatimin e këtij raporti;

Aprovoi kërkesën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe mori vendim për shpalljen e konkursit për avancim të prokurorëve për dy pozita: një (1) në Departamentin për të Mitur dhe një (1) në Departamentin për Krime të Rënda;

Diskutoi kërkesën e Koordinatorës Nacionale për Zgjedhje dhe mori vendim që e njëjta t'i dërgohet për shqyrtim Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel;

Njoftoi për pensionimin e prokurores së Prokurorisë së Apelit, znj. Bedrije Sylja – Alshiqi, për të cilën do të dërgojë propozimin në Zyrën e Presidentes për lirim nga detyra me rastin e pensionimit të saj;



Miratoi propozimin e Kryeprokurores së Prokurorisë Themelore në Pejë për caktimin e znj. Arlinda Nallbani – Shabani në detyrën e Zëvendëskryeprokurores së kësaj prokurorie;

Miratoi marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore në rastin AD.nr.6/2024-l.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi ofroi mbështetjen e tij për Zyrën për Rikthimin e Aseteve

Prishtinë, 6 shkurt 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendi mori pjesë në takimin e përbashkët të Udhëheqësit të Zyrës për Rikthim të Aseteve - Prokurorit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Bahri Hyseni, me zyrtarët e deleguar nga institucionet ligj zbatuese në këtë zyrë. Në këtë takim morën pjesë edhe partnerët ndërkombëtar që e mbështesin punën e kësaj zyreje që nga themelimi i saj.



Gjatë këtij takimi u diskutua raporti vjetor i punës për vitin 2024, si dhe planifikimi i punës për vitin 2025 dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Zyra për Rikthim të Aseteve.

Me këtë rast Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, duke vlerësuar lartë punën që ka bërë Zyra për Rikthim të Aseteve që nga funksionalizimi i saj, ofroi përkrahjen dhe mbështetjen e tij për këtë Zyrë me qëllim për të arritur sukseset e përbashkëta të Zyrës për Rikthim të Aseteve.

Gjithashtu edhe në këtë takim Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, falënderoi partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen dhe ndihmën e dhënë në forma të ndryshme për themelimin dhe funksionalizimin e Zyrës së Rikthimit të Aseteve dhe shprehu gatishmërinë e tij për vazhdim të bashkëpunimit me të gjitha institucionet tjera ligj-zbatuese me qëllim të funksionimit sa më të mirë të kësaj Zyreje.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit mbajti takim me prokurorët-koordinatorë për rastet e trafikimit me qenie njerëzore dhe prokurorët e departamenteve për të mitur të prokurorive themelore

Prishtinë, 6 shkurt 2025 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendi, ka mbajtur takim me koordinatoren nacionale znj. Sebahate Sinani dhe koordinatorët e prokurorive për rastet e trafikimit me qenie njerëzore, ku kanë marrë pjesë edhe prokurorët nga departamentet për të Mitur në prokuroritë themelore.



Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me rastet e trafikimit me qenie njerëzore gjatë vitit 2024, si dhe një sërë çështjesh të rëndësishme profesionale që ndërlidhën me luftimin e trafikimit me qenie njerëzore duke përfshirë edhe sfidat me të cilat ballafaqohen prokurorët gjatë trajtimit të rasteve të trafikimit.

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendi theksoi se përherë ekziston gatishmëria e tij për t'i mbështetur prokurorët që i trajtojnë këto raste, duke theksuar se trafikimi me njerëz është një ndër veprat me komplekse e paraparë në Kodin Penal që kërkon qasje profesionale dhe konstruktive në nga ana e prokurorëve.

Mbajtja e këtij takimi është mbështetur nga projekti rajonal "Mbështetja e BE-së për përmirësimin e luftës kundër kontrabandës së emigrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor "EU4FAST WB", prezantimi i të cilit projekt u bë në fund të këtij takimi.

Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje nga sistemi prokurorial u takua me përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit

Prishtinë, 7 shkurt 2025 – Përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit, kryesuar nga zëvendësja e Avokatit të Popullit znj. Majlindë Sinani Lulaj, vizituan sot Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ku u pritën në takim nga Koordinatorja

Nacionale për Zgjedhje, prokurorja nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Laura Pula.



Gjatë këtij takimi u diskutua për rrjedhën e procesit zgjedhor për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025 e me theks të veçantë u diskutua për planin operativ të Prokurorit të Shtetit në ditën e zgjedhjeve.

Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje, znj. Pula informoi të pranishmit për angazhimin e Prokurorit të Shtetit lidhur me mbrojtjen e votës së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.



Po ashtu gjatë këtij takimi u diskutua për koordinimin në mes të prokurorive dhe Koordinatorës Nacionale lidhur me të gjitha aktivitetet e Prokurorit të Shtetit që do të ndërmerren në rast se do të ketë cenim të procesit zgjedhor, si dhe duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërinstitucional në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit për procesin zgjedhor.

Ndërkaq, zëvendësja e Avokatit të Popullit znj. Majlindë Sinani Lulaj informoi prokuroren Pula për angazhimin e monitoruesve nga institucioni i Avokatit të Popullit, për rrjedhën e procesit zgjedhor, për rolin e tyre dhe shpërndarjen e tyre në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Për ta mbrojtur votën e lirë të qytetarëve sot rreth 100 prokurorë të shtetit po qëndrojnë kujdestarë

Prishtinë, 9 shkurt 2025 – Për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që po mbahen sot në vendin tonë, Prokurori i Shtetit ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të realizuar mbrojtjen e votës.



Në këto zgjedhje janë angazhuar rreth 100 prokurorë dhe numër i mjaftueshëm i personelit të sistemit prokurorial, të cilët do të qëndrojnë kujdestarë deri në përfundim të procesit zgjedhor, me qëllim të procedimit të çdo parregullsie që mund të ndodhë në zgjedhjet e sivjetme.

Prokurorët do të qëndrojnë në zyrat e tyre në qytetet ku ekzistojnë prokuroritë themelore, ndërsa në ato vende ku prokuroria nuk ka objekt, prokurorët do të qëndrojnë në stacione policore, ku në bashkëpunim me hetuesit e Policisë së Kosovës do të jenë në mbrojtje të votës së lirë të qytetarëve.

Ndërkaq, koordinatori nacional për zgjedhje, prokuroja Laura Pula do ta mbikëqyrë gjithë mbarëvajtjen e zbatimit të detyrave të koordinatorëve rajonal, prokurorëve të angazhuar dhe prokurorit me detyrë në KQZ.

Prokurori i Shtetit i fton qytetarët e Republikës së Kosovës, të gjitha subjektet politike, institucionet apo organizatat e ndryshme, që të denoncojnë tek prokuroritë përkatëse, çdo rast, për të cilin kanë dyshime se po keqpërdoret ose manipulohet vota në çfarëdo mënyre dhe nga kushdo qoftë.

Prokurori i Shtetit ndalon 8 persona për veprat penale kundër të drejtave të votimit

Prishtinë, 9 shkurt 2025 – Siç Ju kemi informuar edhe më parë për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që u mbajtën sot në vendin tonë, Prokurori i Shtetit ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të realizuar mbrojtjen e votës. Rreth 100 prokurorë dhe numër i mjaftueshëm i personelit të sistemit prokurorial kanë punuar dhe ende janë duke punuar me qëllim të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.



Gjatë ditës së sotme Prokurori i Shtetit ka pranuar disa informata dhe pas verifikimit të tyre deri në mbyllje të procesit të votimit, janë hapur katër raste, kundër tetë personave, kurse informatat tjera janë duke u trajtuar.

Prej tyre:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë pas informatave të pranuar nga qytetarët, ka iniciuar dy raste të ndryshme që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit.

Në rastin e parë ka ndaluar katër persona, për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjti me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale:

“Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, nga neni 210 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, në rastin e dytë ka ndaluar një person, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti me veprimet e tij ka kryer veprën penale: “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, nga neni 210 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka iniciuar dy raste të ndryshme që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit.

Në rastin e parë ka ndaluar një person, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti me veprimet e tij ka kryer veprën penale: “Sulm ndaj personit zyrtar”, nga neni 402 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, në rastin e dytë ka ndaluar dy persona, për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjtit me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale: “Parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar”, nga neni 209 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokurorët e shtetit do të vazhdojnë të kujdestarojnë edhe gjatë numërimit të votave në vendvotime deri në dërgimin e tyre në qendrat komunale.

Me këtë rast Prokurori i Shtetit falënderon qytetarët e Republikës së Kosovës, mediat dhe shoqërinë civile për bashkëpunimin e treguar me Prokurorin e Shtetit me qëllim parandalimin dhe ndjekjen e suksesshme të veprave penale lidhur me këto zgjedhje.

Prokurori i Shtetit ndalon 5 persona për veprën penale: “Cenim i përcaktimit të lirë të votuesve”

Prishtinë, 9 shkurt 2025 – Prokuroria Themelore në Mitrovicë pas informatave të pranuar nga qytetarët, ka iniciuar dy raste të ndryshme që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit.

Në rastin e parë ka ndaluar katër persona, për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjtit me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale: “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, nga neni 210 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, në rastin e dytë ka ndaluar një person, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti me veprimet e tij ka kryer veprën penale: “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, nga neni 210 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.



Prokurorët e Shtetit, të cilët po kujdestarojnë sot, do të veprojnë me urgjencë në secilin rast që mund të paraqitet me qëllim të parandalimit të keqpërdorimeve të mundshme gjatë këtij procesi zgjedhor.

Prokurori i Shtetit sërish i fton qytetarët e Republikës së Kosovës, të gjitha subjektet politike, institucionet apo organizatat e ndryshme, që të denoncojnë tek prokuroritë përkatëse, çdo rast, për të cilin kanë dyshime se po keqpërdoret ose manipulohet vota në çfarëdo mënyre dhe nga kushdo qoftë.

Njoftim për opinionin publik

Prishtinë, 11 shkurt 2025 – Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit informon opinionin publik se Prokuroria Themelore në Prishtinë, gjatë ditës së djeshme, pasi ka pranuar informacion rreth mos-funksionimit të platformës së KQZ-së, ka kërkuar nga ky institucion marrjen e informatave

të nevojshme për të vërtetuar nëse ka elemente të kryerjes së ndonjë vepre penale apo jo.



U.D. Kryeprokurori i Shtetit dhe Ambasadorja e Mbretërisë së Holandës diskutojnë për avancimin e bashkëpunimit në fushën e sundimit të ligjit

Prishtinë, 12 Shkurt 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka pritur në takim Ambasadoren e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, znj. Karin Boven.



U.D. Kryeprokurori Kelmendi dhe Ambasadorja Boven patën diskutime konstruktive për çështje të interesit të përbashkët nga fusha e sundimit të ligjit, përfshirë këtu forcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë përmes projekteve që kanë në fokus sektorin e drejtësisë, progresin dhe sfidat e Prokurorit të Shtetit në luftimin e veprave të ndryshme penale, ecurinë e zbatimit të reformës në drejtësi dhe përpjekjet e sistemit prokurorial në ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit institucional.

Në fund të takimit, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka falënderuar Ambasadoren Boven për mbështetjen dhe ndihmën që Mbretëria e Holandës ka dhënë për institucionin e Prokurorit të Shtetit në funksion të forcimit të sundimit të ligjit, me ç'rast ka shprehur gatishmërinë e tij institucionale që tradita e bashkëpunimit të ndërsjellë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Mbahet punëtori për finalizimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial për vitet 2025-2027

Prishtinë, 13 shkurt 2025 – Këshilli Prokurorial i Kosovës, gjegjësisht Grupi punues për hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027, i udhëhequr nga Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, znj. Jehona Grantolli, ka organizuar një punëtori dyditore për finalizimin e Planit strategjik dhe planit të veprimit të sistemit prokurorial për vitet 2025-2027.



Të pranishëm në këtë punëtori, krahas anëtarëve të grupit punues, janë edhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, anëtarë të KPK-së, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorë dhe prokurorë të prokurorive të vendit, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z. Sami Istrefi dhe stafi administrativ.



Fillimisht, gjatë zhvillimit të sesionit të parë të kësaj punëtorie, znj. Grantolli, falënderoi përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë, konkretisht Ambasadën Amerikane, për ofrimin e ndihmës për hartimin e draftit kryesor me anë të ekspertëve të tyre në punëtorinë e kaluar. “Ky plan strategjik që është në finalizim e sipër do të ndihmojë sistemin prokurorial në planifikimin dhe orientimin e qartë, me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së sistemit prokurorial”, tha znj. Grantolli.

Gjatë fjalës së tyre, edhe Kryesuesi Hajdaraj dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, theksuan rëndësinë e madhe të definimit të objektivave, nënobjektivave, planifikimin e veprimeve dhe aktiviteteve konkrete të sistemit prokurorial, që do të shërbejnë për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Gjithashtu, pjesëmarrësit e tjerë të punëtorisë, diskutuan për çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen e pavarësisë, paanshmërinë, dhe funksionimin e sistemit prokurorial dhe ngritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në trajtimin e rasteve të veprave penale.

Kjo punëtori do të vazhdojë edhe gjatë ditës së nesërme dhe pas finalizimit të tërësishëm të Planit strategjik dhe Planit të veprimit të sistemit prokurorial për vitet 2025-2027 do të dërgohet për miratim në KPK.

**Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit,
z. Besim Kelmendi, uron qytetarët e vendit
tonë me rastin e 17-vjetorit të Pavarësisë së
Republikës së Kosovës**



17 Shkurt 2025 –

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Sot, në ditën e pavarësisë, bashkohemi për të
kremtuar një nga ngjarjet me të rëndësishme të
historisë së shtetit tonë.

Njëkohësisht, nderojmë përpjekjet dhe rrugëtimin
e vështirë dhe me plot sakrifica të shumë brezave
për liri, demokraci dhe pavarësi!

Duke kujtuar të arriturat e vendit tonë, qëndrojmë
të palëkundur në forcimin e sundimit të ligjit në
Republikën e Kosovës dhe mbrojtjen e të drejtave
dhe lirive të qytetarëve.

Gjithashtu, mbesim të angazhuar për të ndërtuar
një të ardhme ku drejtësia dhe ligji janë shtyllat
kryesore ku mbështetet progresi dhe zhvillimi ynë
shoqëror.

Urime 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Kosovës!

Me respekt,

U.D. Kryeprokurori i Shtetit

Besim Kelmendi

**Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit,
z. Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në tryezën
e diskutimit për Ligjin e Kompetencave të
Zgjeruara të Konfiskimit dhe Shpëlarjen e
parave të organizuar nga Zyra e Koordinatorit
Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik**

Prishtinë, 18 shkurt 2025



Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z.
Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në tryezën e
diskutimit për Ligjin e Kompetencave të Zgjeruara
të Konfiskimit dhe Shpëlarjen e parave të
organizuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar
për Luftimin e Krimit Ekonomik, që është mbajtur
në Durrës – Shqipëri nga data 18 deri me 21
Shkurt 2025.



U.D. Kryeprokurori i Shtetit kërkon nga kryeprokurorët zbatimin e udhëzimeve të detyrueshme dhe ngritjen e efikasitet në punë

Prishtinë, 25 shkurt 2025 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka mbajtur takim me kolegjiun me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive të vendit dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.



Një nga temat e diskutuara në këtë takim ishte edhe trajtimi me prioritet i veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, si dhe caktimi i prokurorëve koordinatorë për fusha të ndryshme në të gjitha prokuroritë e vendit.

Gjatë diskutimeve profesionale me kryeprokurorët e prokurorive, U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka kërkuar që të zbatohen udhëzimet e detyrueshme të nxjerra nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me qëllim të unifikimit të praktikave në funksion të zbatimit të ligjit.

Gjithashtu, U.D. Kryeprokurori i Shtetit në këtë takim ka ngritur edhe çështjen e performancës së të gjithë prokurorëve të prokurorive përgjatë vitit të kaluar, ku ka kërkuar që t'i kushtohet rëndësi më e madhe ngritjes së efikasitetit të prokurorëve konform normës orientuese me qëllim të përmirësimit të rezultateve të përgjithshme të punës.